



## **RAPORT I PJESSHËM MONITORIMI I PROCESIT TË AFISHIMIT TË LISTAVE PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHËSVE**

### **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Afishimi i listave përfundimtare të zgjedhësve, siç dihet është një proces tepër i rëndësishëm, sepse ai u krijon mundësinë zgjedhësve të njihen me to dhe në raste të veçanta t'i drejtohen Gjykatës (janë rastet kur emri i tyre nuk figuron në lista, por zgjedhësi është i regjistruar në gjendjen civile të zonës përkatëse).

Pikërisht për këtë arsye, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) prej datës 7 – 10 Qershor 2019, realizoi një monitorim për të konstatuar në vend zbatimin e kësaj detyre ligjore.

Sipas pikës 3 të nenit 56 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-të janë të detyruara të shpallin në një vend të dukshëm dhe me akses për zgjedhësit listat përfundimtare të zgjedhësve. Kjo detyrë duhej të kryhej brenda datës 26.05.2019.

Monitorimi u krye në 8 rrethe të vendit, përkatësisht: Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë.

Gjatë monitorimit të mësipërm rezultoi se:

- Në shumicën e KZAZ-ve të monitoruara, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se janë respektuar afatet ligjore të sipërcituara. Gjatë monitorimit të KZAZ-ve nr. 47, 48 dhe 49 në Elbasan, nga anëtarët e këtyre komisioneve, vëzhguesit të KShH-së iu referua se marrja në dorëzim e listave përfundimtare më dt. 29.06.2019. Kjo vonesë ishte shkaktuar për arsye teknike të printimit të tyre. Në KZAZ nr. 48 në Tiranë u konstatua marrja në dorëzim e listave më dt. 30.06.2019. Përfaqësuesit e KZAZ-së pretenduan se marrja në dorëzim është realizuar më parë, por procedura e dokumentimit në protokoll për shkak të ngarkesës është realizuar me vonesë. Mungesë të pasqyrimit në librin e protokollit të procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe të shkresës përcjellëse, u konstatua edhe në KZAZ nr. 33 në Tiranë.
- Për shkak të përsëritur të mosprezencës së sekretarit të KZAZ nr. 41 në Tiranë, vëzhguesi i KShH-së nuk pati mundësi të realizonte kqyrjen e librit të protokollit, regjistrin të vendimarrjeve etj. Kryetari i kësaj KZAZ-je na vuri në dijeni se në QV nr. 2023 dhe nr. 2010, është vërejtur rezistencë dhe mosrakordim nga ana e institucioneve shtetërore për të afishuar listat në ambientet e tyre. Gjatë monitorimit në KZAZ nr. 36 në Tiranë, vëzhguesi i KShH-së ka vërejtur se në zonën e Astirit nuk është realizuar publikimi i listave. Kjo problematikë ka ardhur për shkak të rezistencës së qytetarëve. Si zgjidhje, kryetari i kësaj KZAZ-je ka referuar se është realizuar afishimi në të njëjtat ambiente në të cilat është zhvilluar më parë procesi i zgjedhjeve. Gjithashtu, vëzhguesi i akredituar i KShH-së ka konstatuar se procesi i afishimit të listave përfundimtare nuk ka nisur ende në KZAZ nr. 30 në Tiranë. Në qytetin e Shkodrës, vëzhguesi i KShH-së ka vërejtur në mënyrë të përsëritur se KZAZ-të nr. 2, 3, 4 dhe 5 nuk kanë të afishuar asnjë tabelë/shenjë identifikuese mbi vendndodhjen e tyre. Në

qendrat e vendosura në zonat periferike si Gur i Zi dhe Rrenc nuk është realizuar afishimi i listave përfundimtare të zgjedhësve.

- Të gjitha listat e afishuara, sipas formatit të kërkuar nga KQZ, përmbajnë vetëm datën 30.06.2019, në të cilën do të realizohen zgjedhjet. Me qëllim garantimin e parimit të transparencës, KShH sugjeron që në këto lista të ndiqet i njëjti rregull si për ekstraktet e përbërësve zgjedhorë, duke pasqyruar dhe datën e publikimit nga ana e KZAZ-së.

Vëzhguesit e KShH-së kanë verifikuar 2-3 QV në terren, pjesë e juridiksionit të KZAZ-ve të monitoruara. Nga ky monitorim rezultoi se listat e afishuara janë të nënshkruara dhe të vulosura nga ana e kryetarit të njësisë administrative dhe përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile. Në disa prej qendrave të votimit është konstatuar se listat janë vendosur në lartësi mbi gjatësinë e një individi të zakonshëm, duke krijuar vështirësi në aksesin e tyre nga qytetarët. P.sh: Vëzhguesi i KShH-së vërejti se listat e afishuara në ambientet e jashtme të shkollës 9 vjeçare “Ahmet Gashi”, që përfshin qendrat e votimit nr. 2014, 20141 dhe 20142, ishin grisur dhe dëmtuar.



Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se aksesin në listat përfundimtare të zgjedhësve pas orarit zyrtar është i pamundur. Ndërkohë gjatë zhvillimit të orarit mësimor, hyrja në ambientin e shkollave, ku këto lista janë të publikuara është e kufizuar në mënyrë të pjesshme. Ky fakt bie ndesh me garantimin e afishimit të listave në një ambient me akses të lirë për zgjedhësit, parashikuar në pikën 3 të nenit 56 të Kodit.



*This report has been produced with the financial assistance of the Federal Republic of Germany. The implementation of this project is carried out by Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the Federal Republic of Germany.*